

**VENDIM**  
**Nr.110, datë 26.1.2011**

**PËR MIRATIMIN E PROTOKOLLIT TË MIRËKUPTIMIT DHE TË MARRËVESHJES  
SË LIDHUR, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË  
SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA ORGANI SHTETËROR I AUTORIZUAR (OSHA),  
I PËRBËRË NGA MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS,  
MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT, MINISTRI I FINANCAVE DHE  
MINISTRI I MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE, DHE  
SHOQËRISË “LA PETROLIFERA ITALO-ALBANESE” SHA, “PIA”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9231, datë 13.5.2004 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së koncesionit, të formës “BOO”, për ndërtimin dhe shfrytëzimin e terminalit bregdetar, për depozitimin e naftës dhe nënprodukteve të saj në Gjirin e Vlorës”, si dhe për ratifikimin e “Marrëveshjes së koncesionit të formës “BOT”, për ndërtimin dhe shfrytëzimin e infrastrukturës portuale në shërbim të terminalit bregdetar në Gjirin e Vlorës”” dhe të pikës 4 të nenit 21 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, të Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Miratimin e protokollit të mirëkuptimit dhe të marrëveshjes së lidhur, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA), i përbërë nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit, Ministri i Financave dhe Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, dhe shoqërisë “La Petrolifera Italo-Albanese” sh.a., “PIA”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**